



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 957 / prot.
4

Tiranë, më 23.07.2019

REKOMANDIM

Nr. 34, datë 23.07.2019

PËR KONTROLLUESIN "DRITA TRAVEL"

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31, pika 1, gërma a/1, dhe 32, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Drita Travel";

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.188, datë 17.06.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Drita Travel" me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi "Drita Travel".

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "Drita Travel" konstatoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21, dhe 22, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Detyrimi për njoftim është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore që duhet të përmbush Kontrolluesi përpara se të përpunojë të dhëna për herë të parë. Përditësimi

i formularit të njoftimit i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi çdo përpunim të të dhënave personale që kryen kontrolluesi dhe mundësinë e ushtrimit të të drejtave që ju jep ligji. Detyrimi për përditësim ekziston sa herë përpunohen kategori, nivele, apo sasi të ndryshme të të dhënave personale

2. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregulla specifike për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e sigurisë e të dhënave personale. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi dhe përdorimi nga nëpunësit e tij të një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe sqaron punonjësit për të dhënat personale, rëndësinë e tyre, ruajtjen e fshehtësisë si dhe mënyrën e administrimit të tyre. Për këtë arsye duhet të hartohet një rregullore e detajuar e cila të jetë e zbatueshme në praktikë dhe të reflektojë edhe masa konkrete, sipas standardit të parashikuar.

3. Kontrolluesi pretendoi se ka parashikuar në kontratat e punës një dispozitë të veçantë në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit nga punëmarrësit e shoqërisë, sipas parashikimit të nenit 28, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", por nuk i vendosi në dispozicion me argumentin se kontratat ndodhen në mjediset e shoqërisë së kontabilitetit.

Qëllimi i nënshkrimit të kësaj deklarate është fakti që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në informacione lidhur me të dhënat personale, të tyre apo të klientëve, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë për ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin e formalizuar me titull "*Deklaratë Konfidencialiteti*", dalë në zbatim të Vendimit nr. 6/2013 të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*", merren përsipër të drejta dhe detyrime lidhur me mos transferimin në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar. Me nënshkrimin e një akti të tillë, synohet ndërgjegjësimi i plotë i deklaruësit ndaj punëdhënësit për ruajtjen e të dhënave personale, të dhënat që i mëson për shkak të detyrës apo pozicionit që ka, si dhe paralajmërohet marrja e masave të menjëhershme administrative në rast të shkeljes së këtij standardi.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi, nëpërmjet të cilit mbikëqyr hyrjen dhe ambientin e brendshëm të zyrës. Kontrolluesi nuk informon nëpërmjet tabelave, subjektet e të dhënave "nëpunës", "vizitor", etj., mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV), sipas standardit të Udhëzimit nr.3/2010 të Komisionerit.

Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë, etj.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin e konstatimit, më datë 17.06.2019, i cili u lexua dhe u nënshkrua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit deklaroi se do shprehej mbi realizimin në kohë të konstatimeve të grupit të kontrollit dhe pretendimet përkatëse.

Në zbatim të neneve 87-89, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kontrolluesi "Drita Travel" është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore në datën 02.07.2019 pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancë dhe ka parashtruar pranë Zyrës së Komisionerit pretendimet në lidhje me konstatimet e hetimit administrativ, ku ka dokumentuar:

- Njoftimin sipas nenit 21, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar;
- Hartimin e Rregullores;
- Përditësimin e tabelave për njoftimin e klientëve dhe punonjësve në lidhje me pranin e sistemit CCTV, sipas standardit të parashikuar në Udhëzimin nr.3/2010, të Komisionerit;
- Nënshkrimin e "Deklaratave të Konfidencialitetit" me punëmarrësit, të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, sipas standardit të Vendimit nr.06, datë 05.08.2013, të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit ka marrë në konsideratë faktin që pranë kontrolluesit nuk është kryer hetim administrativ i mëparshëm, bashkëpunimi i treguar me grupin e kontrollit si dhe reagimi i menjëhershëm pas konstatimit të shkeljeve.

Në dokumentet e depozituara ku dokumentohet rikuperimi i shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij, konstatohet se Rregullorja e paraqitur është mjaft e kufizuar, nuk reflekton detyrimet ligjore sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon kontrolluesi duke i munguar element të rëndësishëm si baza ligjore, qëllimi dhe kriteret e përpunimit të të dhënave personale, si dhe të drejtat e subjektit të të dhënave personale.

Gjithashtu, konstatohet se Formulari i Njoftimit nuk është plotësuar në disa rubrika si: "*Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*", "*Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*", "*Të dhëna sensitive që përpunohen*", "*Qëllimi i përpunimit*" dhe "*Masat e sigurisë dhe politikave të ruajtjes së të dhënave personale*".

Për rrjedhojë, Kontrolluesi duhet të mbajë parasysh përmirësimin e rregullores specifike për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e sigurisë e të dhënave personale, si dhe të plotësojë dhe përditësojë Formularin e Njoftimit sa herë kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve, 21, 27, 29, 30, 31 pika 1, gërma a/1 dhe 32 të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Drita Travel", të përmirësojë rregulloren e brendshme në të cilën të parashikohen masa konkrete organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat dhe aksesin në të dhëna, etj., në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 6/2012 të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale".
2. Kontrolluesi "Drita Travel", në zbatim të neneve 21, dhe 22, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje plotësimin e "Njoftimit" pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me : "Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen", "Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen", "Të dhëna sensitive që përpunohen", "Qëllimi i përpunimit" dhe "Masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale", si dhe të ketë në vëmendje përditësimin e "Njoftimit" pranë Zyrës së Komisionerit, sa herë përpunohen kategori, nivele, apo sasi të ndryshme të të dhënave personale.
3. Kontrolluesi "Drita Travel.", të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
4. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2, dhe 39, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 23.07.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

